



Leading Towards
Sustainable Gender
Equality Plans in research
performing organisations



This project received funding from the
European Union's Horizon 2020 Research and
Innovation program under Grant Agreement
n° 873072 (01/01/2020-31/12/2023)



Në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë dhe transformimin strukturor të PBGj-ve (Planeve të Barazisë Gjinore), LeTSGEPs-i nxit integrimin e PBGj-ve në ciklin buxhetor, të përmirësuar më tej nëpërmjet qasjes së Buxhetimit Gjinator (**PBGj^{BuGj}**), që përfshin perspektivën gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor.

PBGj^{BuGj} e zbatuar nga partnerët e LeTSGEPs-it pasqyron angazhimet e tyre konkrete sa u përket politikave, me qëllim promovimin e Barazisë Gjinore.



Leading Towards Sustainable
Gender Equality Plans
in research performing
organisations

Orientimi drejt planeve të
qëndrueshme të barazisë
gjinore në organizatat që
kryejnë kërkime



Çfarë?

Projekti i LeTSGEPs-it i koordinuar nga Universiteti i Modenës dhe Reggio Emiliat (Unimore) nxit hartimin dhe zbatimin e Planeve të Barazisë Gjinore (PBGj) dhe Buxhetimit Gjinor në gjashtë Organizata që Kryejnë Kërkime (OKK), ku rolin monitorues e luan Universiteti RWTH Aachen (Gjermani).

Përse?

Hartimi i veprimeve dhe miratimi i masave që trajtojnë anshmërinë gjinore duke nxitur ndryshimin institucional sistemik në gjashtë Organizata që Kryejnë Kërkime (OKK) duke hedhur hapat e tyre të parë drejt zbatimit të Barazisë Gjinore.



Kush?



Projekti LeTSGEPs-it është koordinuar nga University of Modena and Reggio Emilia, Italy. Lista e gjashtë organizatave që janë përgjegjëse për zbatimin e projektit janë:

- Mathematical Institute of the Serbian Academy of Sciences and Arts, Serbia

- University of Messina, Italy
- University of Tirana, Albania
- Max-Planck-Gesellschaft, with its Max Planck Institute for Biological Intelligence (former Max Planck Institute of Neurobiology) and the Central Gender Equality Office of the Max Planck Society, Germany
- Institut de Ciències del Mar / Agencia Estatal Consejo Superior de Investigaciones Científicas, Spain
- CY Cergy Paris Université, France

Rolin e monitoruesit e ka luajtur RWTH Aachen University, Germany

Si?

- Duke krijuar një kuadër metodologjik për PBGj të qëndrueshme dhe të efektshme me Buxhetimin Gjinor të integruar (PBGjBuGj)
- Duke mbështetur hartimin e PBGj-ve në OKK me profile të ndryshme
- Duke zbatuar në mënyrë efektive PBGj-të në OKK
- Duke monitoruar, vlerësuar dhe përmirësuar PBGj-të
- Duke nxitur pjesëmarrjen dhe rrjetëzimin ndërmjet palëve të interesit
- Duke ndarë dhe komunikuar rezultatet e projektit dhe metodologjitë e përdorura



Arritjet

Partnerët zbatues të LeTSGEPs-it i miratuan PBGj-të për **herë të parë** në Institucionet/Departamentet përkatëse, duke tejkalluar rezistencën administrative dhe atë politike.

Ata hartuan një **agjendë të strukturuar dhe sistemike për Barazinë Gjinore**, ku ndërthuren PBGj-të dhe Buxhetimi Gjinor. Disa prej tyre arritën të shndërroheshin nga zbatues të hershëm në pionierë të Barazisë Gjinore në vendet përkatëse.

Produktet

- 6 Plane të Barazisë Gjinore me qasje Buxhetimi Gjinor (PBGjBuGj), të testuara dhe të rishikuara nga secili institucion partner
- 118 masa specifike për PBGj-të, me TKP specifike
- 20 seanca trajnimi të posaçme për partnerët me qëllim ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e aftësive lidhur me barazinë gjinore
- 1 Platformë monitorimi
- 1 Shkollë verore ndërkombëtare për studentët doktorantë dhe Studiuesit në Fillesat e Karrierës (SFK), për nxitjen e përfshirjes së dimensionit gjinor në kërkim dhe për rrjetëzim
- 1 Doracak me burime të hapura dhe Materiale trajnimi në 6 gjuhë
- 6 Punime akademike të paraqitura në konferenca ndërkombëtare dhe të botuara në Open Access
- 60 workshop-e publike dhe konferenca ndërkombëtare për ndarjen e metodologjive dhe rezultateve dhe për përmirësimin e rrjetëzimit
- 421 individë të trajnuar

Impact

- **4 Oficerë për Mundësi të Barabarta, të caktuar rishtas, si dhe Pika Fokale për Barazinë Gjinore** te 4 partnerë konsorciumi
- Përmirësimi i njohurive për **Barazinë Gjinore** nëpërmjet përdorimit të treguesve të saktë dhe një sondazhi rreth anshmërisë gjinore, të kryer në përputhje me udhëzimet e LeTSGEPs-it.
- Përmirësimi i ekuilibrit gjinor në **ekipet e menaxhimit** (d.m.th., rolet institucionale)
- **Integrimi i përhershëm i Buxhetimit Gjinor** në Standardet institucionale për Planet e Barazisë Gjinore në Unimore dhe te partnerët zbatues
- Integrimi i aspekteve të Buxhetimit Gjinor në **financimin e brendshëm**
- Ofrimi i **kurseve të trajnimit** rreth Barazisë Gjinore dhe Buxhetimit Gjinor
- Krijimi i një **protokolli/procedure** me qëllim trajtimin e ngacmimit seksual dhe atij me bazë gjinore

HAPAT E MËTEJSHËM

Ndryshimet më madhore të kryera nga secili partner përfshijnë:

Promotorët e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 5 (OZhQ5) për Barazinë Gjinore - CY Cergy Paris Université (CY) në vitin 2023 spikat në Renditjet Akademike për Renditjet e Ndikimit të Times Higher Education (THE) dhe renditet në vendin e tretë në Francë lidhur me OZhQ5-n.

Gjenerimi novator i Fondeve të Brendshme - Institut de Ciències del Mar (ICM) krijoi një procedurë të re verifikimi për të garantuar ndjeshmërinë gjinore gjatë shpërndarjes së fondeve nëpërmjet thirrjeve konkurruese të brendshme.

Një model referimi për zbatimin e PBGj^{BuGj} - Mathematical Institute of the Serbian Academy of Sciences and Arts është Instituti i parë Kërkimor në Serbi që ka hartuar një PBGj, duke përcaktuar kështu procesin dhe trajnimin e LeTSGEPs-it si një model reference për OKK-të e tjera

Një perspektivë e re për zbatimin e një PBGj-je me një Analizë BuGj-je -Max Planck Institute for Biological Intelligence ndoqi një qasje të gjerë dhe sistemike ndaj Buxhetimit Gjinor në PBGj-në përkatëse.

Salla e parë Rozë - University of Messina inauguroi Sallën e parë Rozë për ushqyerjen me gji, duke i dhënë kështu fillësë hapjes së sallave të tjera rozë në kampuset e universiteteve të tjera.

Përfshirja e Barazisë Gjinore në kurrikulën universitare - BGj-ja u përfshi për herë të parë në programin formues të vitit 2023 në University of Tirana dhe u shpërnda edhe në universitete të tjera.

Për të mësuar rreth nismave të tjera frymëzuese, shihni Doracakun e LeTSGEPs-it të disponueshëm në (vendosni linkun dhe kodin QR)

Ndryshimi transformues i partnerëve të LeTSGEPs-it ka një efekt stimulues ndaj palëve të tjera të interesit:

- **Përkrahja aktive e OKK-ve të tjera** sa i përket hartimit dhe projektimit të PBGj-ve;
- **Pjesëmarrja në konferenca kombëtare** dhe ndërkombëtare për të ndarë vizionin dhe përvojat e LeTSGEPs-it me **Projektet Simotra të Horizon 2020**, OKK-të e tjera dhe studiuesit;
- Vendosja në dispozicion e **materialeve të trajnimit dhe doracakut** në anglisht dhe në gjuhët e partnerëve

Rekomandimet tona për aktorët e interesuar që të angazhohen ndaj Planeve të Barazisë Gjinore dhe Buxhetimit Gjinor:

- **Identifikoni** nivelin e lartë drejtues dhe stafin e posaçëm për ngritjen e një **komiteti** përgjegjës për hartimin e PBGj-ve
- Përfshini në mënyrë aktive **palët e interesit** të brendshme dhe të jashtme dhe ofrojuni trajnim të vazhdueshëm dhe cilësor
- Angazhoni **vendimmarrësit** në procesin e hartimit të PBGj-ve dhe zbatoni një strategji trajnimi
- **Aplikoni një perspektivë Buxhetimi Gjinor** ndaj masave të PBGj-së dhe integrojini ato në sistemin e raportimit për **Ilogaridhënien**
- Gjatë fazës së zbatimit, identifikoni departamentin/ sektorin përgjegjës për secilin veprim dhe, brenda **tij, përcaktoni personin përgjegjës**
- Zbuloni **mangësitë dhe mossukseset** gjatë procesit të zbatimit dhe diskutoni mësimet e nxjerra
- Miratoni **udhëzime për zbatimin** e brendshëm, që përfshijnë një instrument të posaçëm për të siguruar proceset e menaxhimit të përditshëm
- Përditësoni treguesit e barazisë gjinore duke shtuar parime të reja për orientim dhe vlerësim

Partnerët



UNIMORE
UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI
MODENA E REGGIO EMILIA



RWTHAACHEN
UNIVERSITY

MAX PLANCK
GESELLSCHAFT



ICM Institut
de Ciències
del Mar

Kontakte

info@letsgeps.eu

Koordinatorë e Projektit

Profesoreshë Tindara Addabbo
(Unimore)

Menaxhere e Projektit

Anna Maria Sansoni, PhD
(Unimore)

Twitter dhe LinkedIn

www.letsgeps.eu